



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



KRYETARI I KRYEQYTETIT

Nr. 14-343/06-60064, më 30 APR 2025

Në bazë të dispozitave të neneve 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L - 040 për Vetëqeverisje Lokale dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës 01.nr.110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

URDHËRESË

1. NDALOHET qarkullimi i të gjitha automjeteve në drejtim të parkut "Gërmia", përveç autobusëve të linjës 4 të NPL "Trafiku Urban", automjeteve të Policisë së Kosovës, të KFOR-it, të EULEX-it, të NPL "Gjelbër", të KRM "Pastrimi", të Drejtorisë së Inspeksionit dhe automjeteve emergjente, për nder të ditës ndërkombëtare të punës - 1 Maj 2025, ndërsa linja 5 e transportit publik do të punojë sipas itinerarit dhe orarit të rregullt deri në Sofali.
2. Pika përfundimtare për lëvizjen e automjeteve, përveç banorëve të lagjeve: "Normale", "Sofalia", "Tauk-Bahçe" dhe restoranteve: "Gërmia", "Freskia" dhe "Soma", është:
 - Kryqëzimi i rrugëve "1 Tetori" - "Nazim Gafurri" dhe "Ymer Lutfi Paqarizi";
 - Kryqëzimi i rrugëve "Nazim Gafurri" - "Xhavit Ahmeti" dhe "Dr. Lec Gradica";
 - Kryqëzimi i rrugëve "Dr. Shpëtim Robaj" me atë të Sofalisë, në drejtim të pishinës dhe parkut "Gërmia".
3. Transporti publik i qytetarëve për në parkun "Gërmia" deri te pishina, do të bëhet ekskluzivisht me autobusë të NPL "Trafiku Urban", linja 4.
4. Inspektorët e Drejtorisë së Inspeksionit, janë përgjegjës për:
 - Parandalimin e shërbyesve të paautorizuar që të bëjnë shitjen - shërbimin ndaj qytetarëve;
 - organizimin e kujdestarisë, me qëllim të ruajtjes së ambientit (përdorimin e zjarreve për destinime të ndryshme), si dhe hedhjen e mbeturinave në vende të caktuara.



5. Zyra për marrëdhënie me publikun do t'i njoftojë qytetarët dhe subjektet tjera për këtë urdhëresë, përmes mediave të shkruara dhe elektronike.
6. Kjo urdhëresë hyn në fuqi në ditën e marrjes së saj.

U DORËZOHET:

- NPL "Trafiku Urban";
- Drejtorisë së Inspeksionit;
- Policisë së Kosovës;
- **Zyrës për marrëdhënie me publikun;**
- Qendrës për shërbime me qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

